



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:116562

Datë: 11.08.2023

Numri i dokumentit: 04575919

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit E.R., nga fshati ... Rr. "...", komuna Shtime, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. 111/2023, të datës 10.08.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit E.R., në një të anë dhe të dëmtuarit të mitur E.S. me përfaqësues ligjore S.G. me vendbanim në Rr. "...." në Ferizaj, në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.664/2023, të datës 30.05.2023, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 11.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.111/2023, e datës 10.08.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit E.R., nga fshati ... Rr. "...", komuna Shtime, në një të anë dhe të dëmtuarit të mitur E.S., me përfaqësues ligjore S.G. me numër personal, në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 664/2023, e datës 30.05.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit E.R., nga fshati ... Rr. "...", komuna Shtime, i lindur me datë ..., me numër personal ..., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.664/2023, të datës 30.05.2023, e ka akuzuar të pandehurin E.R., nga fshati, Rr. "...” komuna Shtime, lidhur me veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Më datë 07.08.2023, është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe në këtë shqyrtim fillestar bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 10.08.2023 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. 111/2023, në mes të pandehurit E.R., nga fshati ... Rr. "...”, komuna Shtime, i lindur me datë, me numër personal ..., në njërën anë dhe të dëmtuarit E.S. me përfaqësues ligjore S.G. me numër personal, në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:122441, datë 11.08.2023

Zyrtarja ligjore,

Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimin të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.